

HOUSE OF CARDS

Programi i Qeverisë 2020-2023

HOUSE OF CARDS

Programi i Qeverisë 2020-2023

Qershor 2020, Prishtinë

Titulli i publikimit:

HOUSE OF CARDS: Programi i Qeverisë 2020-2023

Publikuar nga:

Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane

Vendi dhe koha e publikimit:

Prishtinë, qershor 2020

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

PËRMBAJTJA

Hyrja	6
Numri masave sipas ministrive	8
15 masa kyçe	9
Kryeministri	10
Ministria e Jashtme dhe Diasporës	11
Ministria e Mbrojtjes	12
Ministria e Drejtësisë	13
Ministria e Financave	14
Ministria e Punëve të Brendshme	15
Ministria e Shendetësisë	16
Ministria e Infrastrukturës	17
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	18
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	19
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	20
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	21
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	22
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	23

HYRJA

Merriam-Webster përkufizon idiomën HOUSE OF CARDS si “strukturë, situatë apo institucion i cili është fragjil apo në rrezikun e përhershëm prej kolapsit.” Idioma HOUSE OF CARDS, edhe pse në gjuhë angleze, është futur në përdorim ditor në të gjithë gjuhët e botës. Meritë në këtë ka edhe seriali i famshëm me po të njëjtin emër i cili portretizon jetën dhe luftën politike në SHBA për pushtet.

Në këtë drejtim për arsye, besojmë, vetevidente kemi vendosur që ky do ishte titulli më i përshtatshëm për të përshkruar Programin e Qeverisë. Kryesisht për 3 arsye:

1. Qeveria është votuar me vetëm 61 vota dhe kjo fal një vote e cila ka ndryshuar mendjen në momentet e fundit. Si e tillë, Qeveria gëzon një përkrahje jashtëzakonisht të brishtë dhe të pa parashikueshme brenda Kuvendit të Kosovës. Një shumicë e tillë e brishtë do e këtë pothuaj të pamundur të avancoj çështjet komplekse politike, siç është vettingu, reforma zgjedhore apo dialogu me Serbinë. Rrjedhimisht, koalicioni do të jetë e obliguar të bëjë konsensus të shumta ndaj zotimeve që ka paraparë në programin qeverisës - nëse dëshiron të mbijetoj;
2. Partitë e koalicionit të cilat janë garant të Programit janë partitë të cilat nuk kanë qëndrime koherente për një gamë të çështjeve të rëndësishme, siç janë: demarkacioni me Malin e Zi, autostrada e Dukagjinit apo çështja e listës së veteranëve. Në mungesë të lidhjeve të thella ideologjike, ato më shumë janë produkt të interesit momental të përbashkët politik, interes i cili mund të avulloj në mënyrë të paparashikueshme;
3. Programi është i pazbatueshëm. Programi ka parapa krijimin e 14 fondeve të ndryshme dhe shpenzime marramendëse, nga ndërtimi i hekurudhës me Shqipërinë, autostrada e Dukagjinit, skema e shtesave për fëmijë e deri te 3 muze dhe 1 stadium nacional – e gjithë kjo në mes të pandemisë COVID-19. Prandaj, Programi nuk arrin të krijoj një bindshmëri për nga zbatueshmeria e tij.

Në këtë kontekst, dhe në harmoni me përkufizimin e idiomës HOUSE OF CARDS, Programi i Qeverisë duket si një dokument i cili është në “rrezikun e përhershme të kolapsit”, siç është edhe koalicioni politik i cili do të duhej të ofronte garanci për zbatimin e tij. Në fakt, vetëm pas 24 orëve të miratimit të Programit, Qeveria veproj në kundërshtim me zotimin kyç të Programit të saj duke anuluar reciprocitetin me Serbinë. Ky vendim i Qeverisë dëshmoj brishtësinë e programit të Qeverisë.

Nga ana tjetër, programi në 58 faqe vendos theksin në rëndësinë e trajtimit të pasojave shëndetësore dhe ekonomike të pandemisë COVID-19. Në këtë drejtim, Qeveria parasheh themelimin e fondit 1.2 miliardë EURO për të adresuar pasojat ekonomike të COVID-19.

Përtej pandemisë COVID-19, programi është i organizuar në 12 fusha të qeverisjes dhe identifikon themelimin e 14 fondeve të ndryshme dhe miratimin e 17 ligjeve. Gjithsej ne kemi identifikuar 136 masa konkrete për të cilat është zotuar Qeveria e Kosovës në kuadër të Programit të saj 2020-2023 - nga masat e reciprocitetit në dialogun me Serbinë, zbatimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, krijimi i eko-fondit, kartoni i gjelbër e deri te avancimi i marrëdhënieve me Bosnjën duke hapur zyrat ndërlidhëse në Prishtinë dhe Sarajevë. Duke pas parasysh numrin e lartë të masave, ne kemi përgatitur edhe një listë të masave kyçe që burojnë nga Programi 2020-2023.

Duhet sqaruar që në fillim që ne kemi tentuar të bëjmë përzgjedhjen e masave të Programit të cilat janë të qarta, konkrete dhe të matshme. Me fjalë të tjera, nuk kemi përfshirë masat e programit të cilat në esencë nuk janë masa, por zotime abstrakte psh. do të konsolidojmë funksionimin e kompanive publike, do të zbatojmë MSA dhe rishikojmë ligjet/strategjitë/politikat, do të forcojmë/fuqizojmë kapacitetet e institucioneve, etj. Po ashtu, nuk kemi përfshirë masat e programit të cilat përbejnë detyrat e zakonshme të qeverisë, psh. përmirësimi i llogaridhënies ndaj qytetarëve, sensibilizimi i bizneseve, fushatat e informimit dhe aktivitete të ngjashme.


Me qëllim të monitorimit më të lehtë dhe rritjes së llogaridhënies ne kemi përgatitur edhe ndarjen e detyrave që burojnë nga Programi i Qeverisë sipas mandatit të secilit ministër. Ministria me më së shumti detyra është Ministria e Arsimit, me gjithsej 22 masat, ndërsa ministrinë për të cilat ne nuk kemi arritur të identifikojmë asnjë masë konkrete janë: Ministria për Kthim dhe Komunitete, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Publikimi i sotëm është në vazhdimësi të serisë së publikimeve përkitazi me programin e çdo Qeverie të re. Qëllimi i publikimit është de-konstruktivi i programit të Qeverisë nga gjuha abstrakte dhe teknike e tij në infografikat e qarta, të matshme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë. Ne shpresojmë se kjo do të ndihmojë në inkurajimin e një diskursi vibrant publik i cili do të kontribuojë në dizajnimin dhe zbatimin e politikave kualitative qeverisëse dhe rritjes së llogaridhënies.



NUMRI MASAVE SIPAS MINISTRIVE

Programi i Qeverisë 2020-2023





15 MASA KYÇE

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

RECIPROCITET I PLOTË NË
RAPORT ME SERBINË

2

PLATFORMA PËR DIALOG
ME SERBINË

3

ZBATIMI I MARRËVESHJES SË
DEMARKACIONIT ME MALIN
E ZI

4

LIBERALIZIMI I VIZAVE
GJATË PRESIDENCËS
GJERMANE

5

REFORMA ZGJEDHORE

6

ELIMINIMI I TË GJITHA
MONOPOLEVE

7

MONITORIMI I PROCESIVE
REKRUTUESE (AMBASADA
BRITANIKE DHE FORMA
TJERA)

8

SHËRBIMI I DETYRUESHËM
USHTARAK

9

VETTINGU

10

FONDI PËR RIMËKËMBJEN
EKONOMIKE NGA COVID-19

11

EKO-FONDI

12

PPP PËR QENDRËN E
SKIJIMIT NË BREZOVICË

13

PRIVATIZIMI I PJESSHËM I
TELEKOMIT TË KOSOVËS

14

REFORMA E FINANCIMIT TË
SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

15

VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT
TË SISTEMIT ARSIMOR NËN
KUSHTET E PANDEMISË



KRYEMINISTRI

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

**RECIPROCITET I PLOTË
NË RAPORT ME SERBINË**

2

PLATFORMA PËR DIALOG ME SERBINË

3

**ZBATIMI I MARRËVESHJES SË DEMARKACIONIT ME
MALIN E ZI**

4

**LIBERALIZIMI I VIZAVE GJATË PRESIDENCËS
GJERMANE**

5

REFORMA ZGJEDHORE

6

LIGJI PËR QEVERINË

7

REDUKTIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

8

ELIMINIMI I TË GJITHA MONOPOLEVE

9

**MONITORIMI I PROCESHEVE REKRUTUESE
(AMBASADA BRITANIKE DHE FORMA TJERA)**



MINISTRIA E JASHTME DHE DIASPORËS

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

**REFORMA E SHËRBIMIT TË JASHTËM,
RIORGANIZIMI I MINISTRISË DHE THEMELIMI
I INSTITUTIT PËR DIPLOMACI**

2

**BOSNJA: HEQJA E REGJIMIT TË VIZAVE,
ANGAZHIMIN PËR NJOHJE NGA KY SHTET,
HAPJA E NJË ZYREVE NDËRLIDHËSE**

3

**ANËTARËSIMI NË INTERPOL, KËSHILLIN E
EVROPËS, OBSH, UPU, FAO DHE ILO.**

4

**PAKETË E VEÇANTË PËR PROMOVIM TË
INVESTIMEVË NGA DIASPORA**



MINISTRIA E MBROJTJES

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

SHËRBIMI I DETYRUESHËM USHTARAK

2

PËRGATITJET PËR ANËTARËSIM NË NATO



MINISTRIA E DREJTËSISË

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

LIGJI PËR VETTING

2

LIGJI PËR KONTROLLIN DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

3

LIGJI KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

4

KRIJIMI I STRUKTURAVE PËR TRAJTIM PRIORITYAR TË ÇËSHTJEVE EKONOMIKE

5

RRITJA E NUMRIT TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË

6

MEKANIZËM PËR MONITORIM TË ZBATIMIT TË LIGJEVE



MINISTRIA E FINANCAVE

Programi i Qeverisë 2020-2023

- 1** FONDI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE PAS PANDEMISË COVID-19
- 2** PEZULLIMI I RREGULLËS FISKALE TË DEFICITIT PREJ 2% PËR TRE VITE
- 3** RITJJA E KUFIRIT TË BORXHIT PUBLIK NGA 40% NË 50% TË PBB-SË
- 4** MOBILIZIMI I 1.2 MILIARDË EUROVE PËR 2020 DHE 2021
- 5** FONDI ZHVILLIMOR-INVESTIV
- 6** PAKOJA E RE TATIMORE
- 7** LIBERALIZIMI I TREGUT TË SIGURIMEVE
- 8** THEMELIMI I AGJENCISË SË TË HYRAVE
- 9** KRIJIMI I STRUKTURAVE PËR MBLEDHJEN E TVSH-SË BRENDA VENDIT
- 10** PËRMBYLLJA E PLOTË E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT
- 11** TRANSFORMIMI I AKP-SË NË NJË AGJENCI BRENDA QEVERISË
- 12** FUNKSIONALIZIMI I PLOTË I PROKURIMIT ELEKTRONIK
- 13** ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË KARTONIN E GJELBËR
- 14** NDRYSHIMI I LIGJIT TË BUXHETIT
- 15** NDRYSHIMI I LIGJIT TË FINANCAVE PUBLIKE
- 16** NDRYSHIMI I LIGJIT TË BORXHIT PUBLIK



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

RRITJA E BUXHETIT PËR POLICINË

2

**PLOTËSIM NDRYSHIMI I KORNIZËS LIGJORE
NË FUSHËN E RENDIT**

3

**ZBATIMI I PLOTË I PAKOS SË REFORMËS SË
ADMINISTRATËS PUBLIKE**



MINISTRIA E SHENDETËSISË

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

COVID-19 & REFORMA E FINANCIMIT TË SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

2

RIORGANIZIMI I QKUK-SË

3

THEMELIMI I INSTITUTIT PËR NËNËN DHE FËMIJËN

4

THEMELIMI I INSTITUTIT PËR SËMUNDJE KARDIOVASKULARE

5

THEMELIMI I SPITALIT TË PRISHTINËS

6

FUNKSIONALIZIMI I SPITALIT TË PODUJEVËS

7

AVANCIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

8

FOND I VEÇANTË I BURSIVE PËR STUDIME NË FUSHËN E MJEKËSISË

9

REFORMIMI I LISTËS ESENCIALE TË BARNAVE DHE MATERIALIT MEDICINAL

10

RIORGANIZIMI I MENAXHMENTIT FARMACEUTIK NË MSH DHE NË FONDIN E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

LIDHJA HEKURUDHORE ME SHQIPËRINË

2

**STACIONI INTERMODAL NË MES TË
PRISHTINËS DHE FUSHË KOSOVËS**

3

NDËRTIMI I AUTOSTRADËS SË DUKAGJINIT

4

**VAZHDIMI I AUTOSTRADËS NË DREJTIM TË
PODUJEVËS DHE PIKËS KUFITARE**

5

**NDËRTIMI I AUTOSTRADËS SË
ANAMORAVËS**

6

NDËRTIMI I AUTOSTRADËS PËR MITROVICË



MINISTRIA E ARSIMIT

Programi i Qeverisë 2020-2023

- 1 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT ARSIMOR NËN KUSHTET E PANDEMISË
- 2 TESTI I ARRITSHMËRISË DHE TESTI I MATURËS DHE PROVIMEVE
- 3 RISHIKIM I STRUKTURËS SË AUTORITETEVE DHE MEKANIZMAVE TË ARSIMIT
- 4 MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS
- 5 VLERËSIM I PLOTË I KURRIKULAVE ARSIMORE
- 6 ZGJERIMI I RRJETIT TË INSTITUCIONEVE TË EDUKIMIN PARAFILLOR
- 7 DEPOLITIZIMI I MENAXHMENTIT TË SHKOLLËS
- 8 FONDI PËR MËSIMDHËNIE INOVATIVE
- 9 RISHIKIMI I LIGJIT PËR ARSIMIN E LARTË
- 10 FONDI I PËRSOSMËRISË
- 11 PROFILIZIMI I UNIVERSITETEVE TË REJA PUBLIKE
- 12 RANGIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË
- 13 SISTEMI I INTEGRUAR I INFORMIMIT
- 14 LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM
- 15 LIGJI PËR FINANCIMIN E ARSIMIT TË LARTË
- 16 SKEMË E VEÇANTË PËR MBËSHTETJE TË STUDENTËVE NGA KOMUNITETET JO SHUMICË
- 17 THEMELIMI I SEKTORIT PËR ARSIM TË KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË MASHT
- 18 RITHEMELIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR I SHKENCËS
- 19 PËRGAËTITJA E PROGRAMIT KOMBËTAR TË SHKENCËS
- 20 THEMELIMI I FONDIT FORMUES
- 21 THEMELIMI I FONDIT TË EKSELENCËS
- 22 FONDI PËR KREDI PËR SHKOLLIM DHE STIMULIM TË STUDENTËVE TË DALLUAR



MINISTRIA E BUJQËSISË

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

DYFISHIMI I BUXHETIT PËR BUJQËSI

2

**ZHVILLIMI I TREGJEVE LOKALE BUJQËSORE
DHE DIGJITALIZIMI I TYRE**

3

**SUBVENCIONIMI I NORMAVE TË INTERESIT
TË KREDIVE NË BUJQËSI**

4

**THEMELIMI I FONDIT TË GRANTEVE PËR TË
RINJTË NË BUJQËSI**

5

**TRANSFERIMI I AGJENCISË SË USHQIMIT
DHE VETERINARISË NË KUADËR TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË**

6

**REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS IBËR-
LEPENCIT DHE RADONIQIT**

7

**FUNKSIONALIZIMI I FONDIT PËR SIGURIME
BUJQËSORE**



MINISTRIA E KULTURËS

Programi i Qeverisë 2020-2023

- 1 RITJJA E BUXHETIT PËR KULTURË
- 2 NDËRTIMI I MUZEUT TË ARTIT BASHKËKOHOR
- 3 NDËRTIMI I MUZEUT TË HISTORISË SË NATYRËS
- 4 NDËRTIMI I MUZEUT ARKEOLOGJIK
- 5 NDËRTIMI I STADIUMIT NACIONAL
- 6 RENOVIMI I GODINËS SË AGJENCISË SHETËTORË TË ARKIVAVE
- 7 RENOVIMI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE "PJETËR BOGDANI"
- 8 STRATEGJIA E RE E SPORTIT
- 9 THEMELIMI I MUZEUT ARKEOLOGJIK & MUZEUT ETNOLOGJIK
- 10 THEMELIMI I MUZEUT TË PAQES
- 11 DIGJITALIZIM I MATERIALEVE BIBLIOTEKARE, ARKIVORE DHE MUZEALE
- 12 KTHIMI I FONDIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE QË NDODHET NË SERBI
- 13 LIGJI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE
- 14 LIGJI PËR MUZETË
- 15 FONDI PËR HULUMTIM / STUDIME NË TRASHËGIMINË KULTURORE
- 16 FONDI KOMBËTAR PËR KONSERVIM/RESTAURIM TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- 17 AVANCIMI I REGJISTRIT NACIONAL TË TRASHËGIMISË KULTURORE



MINISTRIA EKONOMISË DHE AMBIENTIT

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

EKO-FONDI

2

25% E PJESËMARRJES SË ENERGJISË
NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME

3

DEKOMISIONIMI I TC KOSOVA A

4

REHABILITIMI I TC KOSOVA B

5

RISHIKIM I PROJEKTIT KOSOVA E RE

6

STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR KYÇJE NË
PROJEKTIN E GYPIT TRANS ADRIATIK
(TAP)

7

NDËRTIMI I NGROHTORES PËR
DRENAS

8

STRATEGJI GJITHËPËRFSHIRËSE PËR
ZHVILLIMIN E MINIERAVE

9

MIHJA E RE E LINJITIT

10

STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR TREPÇEN

11

IMPIANTET PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE
TË ZEZA PËR PRISHTINËN, PRIZRENIN,
GJAKOVËN, GJILANIN, FERIZAJIN,
MITROVICËN

12

ZHVILLIMI STRATEGJISË KOMBËTARE
TË KONKURRUESHMERISË

13

RIORGANIZIMI I FONDIT PËR
INOVAZIONE

14

SISTEMI I MENAXHIMIT BAZUAR NË
OBJKTIVA NË NDËRMARRJE PUBLIKE

15

AUDITIM I PERFORMANCËS I
NDËRMARRJEVE PUBLIKE NGA ZKA

16

TRANSFERIM I PËRGJEGJËSISË PËR
MBIKËQYRJE TË NDËRMARRJEVE
PUBLIKE NËPËR MINISTRITË
PËRKATËSE

17

RISHIKIM I STRUKTURËS PRONËSORE
TË DISA NDËRMARRJEVE PUBLIKE PËR
FUTJEN KAPITALI PRIVAT

18

SHITJA APO PRIVATIZIM I ASETVEVE TË
DISA NDËRMARRJEVE PUBLIKE
PËRMJET LIGJIT PËR INVESTIMEVE
STRATEGJIKE

19

PRIVATIZIMI I PJESHËM I TELEKOMIT
TË KOSOVËS

20

PËRFSHIRJA E KOSOVËS NE FREE
ROAMING ZONE NE EVROPË

21

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TE
INTERKONEKSIONIT TË TELEFONISË
MOBILE



MINISTRIA E PUNËS

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

LIGJI PËR KËSHILLIN EKONOMIK SOCIAL

2

LIGJI PËR PENSIONE

3

LIGJI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

4

LIGJI PËR SKEMAT SOCIALE

5

LIGJI PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

6

FONDI PËR MBROJTJE SOCIALE

7

GRANTI SPECIFIK PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

8

SKEMA E SHITESAVE PËR FËMIJË

9

SUBVENCIONIMI I PAGAVE, KONTRIBUTEVE TATIMORE DHE PENSIONALE



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Programi i Qeverisë 2020-2023

1

**PPP PËR QENDRËN E SKIJIMIT NË
BREZOVICË**

2

ANËTARËSIMI NË OBT

3

**DECENTRALIZIMI I REGJISTRIMIT TË
BIZNESEVE**

4

**GRANTE PËR START-UP BIZNESE PËR
NDËRMARRËSIT E RINJ**

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

